

PKR.nr. 604/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarë profesionist, Suzana Çerkini kryetare, Afërdita Bytyqi dhe Arben Hoti anëtarë, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit M.D. nga fshati T., Komuna G., sipas Propozimit për shqiptim të masës së trajtimit të detyruar psikiatrik, PP/I-nr.352/16 të datës 24.10.2016, për shkak të veprave penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par 1 të KPRK dhe veprën penale Grabitje nga neni 329 të KPRK, pas perfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 10.11.2016, në prani të prokurorit të shtetit Besa Krajku, të pandehurit M. D., mbrojtësit sipas autorizimit, avokatit H.M., të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTVENDIM

I pandehuri **M. D.**, nga i ati H. dhe nëna Z., e gjinisë D., i lindur me datë *data e lindjes...* në fshatin T., Komuna G., ku edhe jeton, i ve, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 14.07.2016,

Sepse,

I. Me datë 14.07.2016, rreth orës 19:15 në lagj. D. në T. Komuna G., derisa njësitë e zjarrfikësve kanë qenë duke intervenuar në shuarjen e një zjarri, janë penguar nga i dyshuari M. D., në atë mënyrë që i njëjti nën kërcënimin e armëve ua ka grabitur zjarrfikësve kamionin dhe me kamion e ka marr me vete edhe një fëmijë të vetin 5-6 vjeçar, është nisur në drejtim të pishave të bjeshkëve të quajtura “Kamenicë” të fshatit K., dhe kur dy njësitë policore me dy vetura zyrtare, duke përdorur dritat rotative dhe alarmin janë nisur në drejtim kah ka shkuar i dyshuari, në afërsi të shkollës fillore në G., pasi i dyshuari i ka vërejtur ka rritur shpejtësinë e lëvizjes së kamionit të zjarrfikësve, e të cilin ka qenë duke e drejtuar dhe nga shiriti i tij i lëvizjes ka dal në shiritin e kundërt dhe, ballë për ballë e me dashje që t’i privojë nga jeta, ka goditur veturën zyrtare të policisë, të tipit Shkoda Octavia me targa *numër i targave...*, të cilin e ka qit jashtë rrugës, duke e gjuajtur në një kanal, me ç’rast lëndime trupore kanë pësuar zyrtarët policor N. M. me ID *numër ID...* dhe B. K. me ID *numër ID...*, dhe një punëtorë zjarrfikës M. R., kurse kanë qenë të rrezikuar edhe dy pjesëtarë të tjerë të policisë dhe një zjarrfikës që kanë qenë në veturën tjetër, sepse i dyshuari ka vazhduar të shkojë në drejtim të tyre, por i ka rrëshqit kamioni dhe, ka rënë në anën e djathtë të rrugës, duke mbetur pezull mbi veturën e policisë të cilën e kishte goditur paraprakisht,

- me këtë në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par.4 të KPRK,

II. Me datë 14.07.2016, rreth orës 19:15 i dyshuari M. nën kërcënimin e armës revole, ia ka grabitur automjetin zyrtar, kamionin e zjarrëfikësve me targa *numër i targave...*, zjarrëfikësve të cilët kanë qenë duke e shuar një zjarr në fshatin T. dhe me të njëjtin është nisur në fshatin G.,

- me këtë në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogluar mendore ka kryer veprë penale Grabitje nga neni 329 të KPRK,

Andaj gjykata në bazë të neneve 18, 88, 89 par.1 të KPRK dhe neneve 507,514, 515 të KPP ku perfshihen kryesisht me çrregullime mendore i shqipton,

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUAR PSIKIATRIK ME NDALIM

I. I pandehuri M.D. ndalohet për trajtim psikiatrik të detyrueshëm në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë nga data 18.11.2016, deri sa Institucioni shëndetësor të konstatojë se më nuk është e nevojshme që tani i pandehuri të jetë në ndalim për trajtim psikiatrik,

II. URDHËROHET Qendra e Paraburgimit në Dubravë, që të pandehurin M.D. menjëherë ta transferojë në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, në trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim,

III UDHËROHET QKUK- Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, që tani të pandehurin M.D. ta pranojë në këtë institucion shëndetësor për trajtim psikiatrik me ndalim,

IV Institucioni Shëndetësor-QKUK-Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës në Prishtinë, ka për detyrim që gjykatës së paku në çdo gjashtë muaj ti dërgojë Raportin me shkrim mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit,

Kjo gjykatë do të shqyrtojë brenda çdo gjashtë muajve nevojën e vazhdimin të masës së trajtimit të detyruar psikiatrik për tani të pandehurin,

Të dëmtuarit B. K., M. R., N. M. dhe A. K., me shënime personale si në shkresa të lëndës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate,

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 24.10.2016 ka parashtruar në gjykatë Propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, ndaj të pandehurit M. D., për shkak të veprave penale të precizuara si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për të cilat vepra të njëjtit i është caktuar dhe vazhduar masa e paraburgimit nga data e kërjes së veprave me 14.07.2016 deri më 13.12.2016. Kjo masë është propozuar nga prokuroria, pas pranimit të raportit mjekësor të hartuar nga grupi i ekspertëve të Institutit të Psikiatrisë Forenzike, përkatësisht neuropsikiatërve Dr. F. D. dhe Dr.G. H. si dhe psikiatër Sh. H., të datës 30.09.2016.

Gjykata, duke vepruar sipas propozimit të lartshënuar, mbajti shqyrtim gjyqësor, në të cilën ishin të pranishëm i pandehuri M. D., mbrojtësi i angazhuar nga familja, me autorizim, av. H.M., vëllau i të pandehurit I. D. si dhe dy mjekët, që kishin hartuar ekspertizën psikiatrike ku edhe kishin dhënë konstatimin për gjendjen mendore të të pandehurit M. D..

Prokurori i shtetit ka mbetur në tërësi pranë propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, duke bërë njëherit precizimin e të njëjtit në drejtim që të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Me tutje ka shtuar se pas dëgjimit të ekspertit dhe mbrojtjes së të pandehurit si dhe vëllait të të pandehurit të cilët janë pajtuar për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, i propozoi gjykatës masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në IPFK- Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës.

Gjykata ka dëgjuar ekspertin e psikiatrisë, Dr. F. D. neuropsikiatër, i cili ka pohuar se i ekzaminuari jonë M.D. për nevoja të gjykatës është ekzaminuar në Institutin e Forenzikës Psikiatrike, nga data 01.08.2016 deri me datën 26.09.2016, nga gjetjet e ekipit të ekspertëve të psikiatrisë dhe neuropsikiatrisë, konstatohet se fjala është për një person i cili ka në historinë e tij mjaft stresse dhe trauma në rrethin primar, pastaj pjesëmarrës i luftës dhe i plagosur në kokë, janë gjetur ndryshime organike të personalitetit, karakteristika të personalitetit kufitar me mjaft ankesa tjera neurotike dhe stomatike. Lidhur më përgjegjshmërinë e tani të pandehurit M.D. në momentin e kryerjes së veprës penale, aftësia për të gjykuar për rëndësinë e veprës të cilën ka qenë duke e kryer dhe e ka kryer si dhe aftësia për kontrollën e veprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar. Me tutje ka shtuar se duke marrë parasysh gjendjen e lart përshkruar ekipi i ekspertëve i propozon gjykatës që të njëjtit ti propozohet masa e trajtimit të obliguar psikiatrik me ndalesë në institutin përkatës për shkak të gjendjes mjaft të brishtë të shëndetit mendor si dhe për shkak të uljes së mundësisë së përsëritjes së veprimeve të ngjashme. Një trajtim i mirëfillët psikiatrik konform gjendjes së shëndetit mendor, do të ishte në dobi të pacientit në dobi të familjes të rrethit dhe të shoqërisë, në mënyrë që i njëjti pas të gjitha këtyre peripecive, traumave streseve lëndimit në kokë, të rikthehet sadopak në rrethin shoqëror. Po ashtu ka shtuar se trajtimi i obliguar në Institutin e Psikiatrisë Forenzike ndërthet në vete një trajtim multi disiplinor, nga psikiatri, neuropsikiatri, psikologu klinik, punëtori social dhe infermieri i rastit. Sa i përket kohëzgjatjes, do të jetë konform përmirësimit të gjendjes së shëndetit mendor të tij, për të cilën mirëvajtje do të informohet gjykata në afatet e parapara ligjore. Ndërsa Dr. G.H. ka deklaruar se pajtohet në tërësi me mendimin dhe konstatimin e dr. D., ku ka theksuar se sikur për të gjitha rastet edhe për këtë rast është përkujdesur për mbarëvajtjen e ekzaminatit meqë është drejtor i Institutit.

Mbrojtësi i të pandehurit M. D., av. H. M. ka deklaruar se e mbështetë konstatimin e ekspertit të neuropsikiatrisë të dhënë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik .

S. D., vëllau i të pandehurit M.D., ka deklaruar se e mbështet në tërësi propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, duke theksuar se i beson punës profesionale të mjekëve, të cilët në përkujdesje të tipit të mbyllur, do të mund të përcjellin gjendjen shëndetësore mentale të vëllaut të tij, dhe do ti ofrojnë mundësinë që i njëjti të përmirësohet.

Në shqyrtimin gjyqësor gjykata plotësisht vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarve M. R., B. K., N. M., A. K., H. M. dhe A. Th., raporti i kqyrjes se vendit të ngjarjes të datës 22.07.2016, foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndes, Raporti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – Instituti i Psikiatrisë Forenzike numër 406/2 i dt.28.09.2016.

Dëshmitarët B. K. dhe N. M. në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se mbeten pranë deklaratave të dhëna në prokurori, në të cilat kanë deklaruar se me datë 14.07.2016, rreth orës 19:00, kanë qenë në detyrë në një vend të ngjarjes Korreticë e Ulët ku kishte ndodhur një aksident, dhe nga shefi i ndërrimit kanë marrur urdhër që të shkojnë në asistencë të njësisë së hetimeve në fshatin T. në lagjen “D.”, ku sipas tyre një njësi e zjarrëfikësve kishte probleme me një person. Kur kanë arritur në atë lokacion janë takuar me kolegët e tyre dhe kanë kuptuar se personi në fjalë M.D. nën kërcënimin e armëve e ka grabitur automjetin e zjarrëfikësve dhe një fëmijë të moshës 4-5 vjeçare, dhe është larguar në drejtim të vendit të quajtur “te vendi i pishave”. Me tutje kanë shtuar se ata si njësi kanë vazhduar në fshatin G. me qëllim që të shkojnë tek vendi ku kanë besuar se ka shkuar i dyshuari, ndërsa me të arritur në fshatin G. në lagjen E., kanë vërejtur automjetin e zjarrëfikësve me drita vezulluese dhe alarm, me çrast i dyshuari ka dal në shiritin e tyre dhe me një shpejtësi ka ardhur nga ta, në këtë rast janë munduar të skajohen anës së rrugës mirëpo i dyshuari qëllimisht e ka goditur automjetin e tyre, duke i gjuajtur në një kanal dy-tri metra i thellë që ishte skaj rrugës, dhe se i njëjti prapë ka vazhduar sulmin me kamionin e tij duke u hedhur mbi veturën e tyre për herë të dytë, me çrast automjeti i tij ka ngecur mbi automjetin e tyre. Ata fillimisht kanë marrë ndihmën e parë mjekësore në vendngjarje, ndërsa me pas kanë vazhduar në QKUK në Prishtinë.

Dëshmitarët M. R., A. K. dhe A. Th., kanë deklaruar se mbeten pranë deklaratave të dhëna në prokurori, me çrast kishin deklaruar se derisa ishin me një intervenim në fshatin T., ku kishin shkuar me intervenu me automjetin e zjarrëfikësve për shkak se kishte shpërthyer një zjarr, një person me armë e grabiti automjetin e tyre dhe nga kojshia e kanë kuptuar se bëhet fjalë për një person të rrezikshëm. Po ashtu kanë shtuar se kanë dëgjuar thirrje me zë të lartë se duke thënë “o ikni se po donë me gjuajtur me allti”, ndërsa personi me armë ka shkuar te kamioni, ndërsa pak momente me vonë kamioni ka lëvizur me personin që ata nuk e kanë njoftur se kush është. Me tutje kanë deklaruar se i kanë njoftuar policinë lidhur me ngjarjen. Ndërsa dëshmitari M. R. ka shtuar se unë bashkë me polic kam vazhduar në drejtim të fshatit G., me çrast kur kanë arritur në lagjen “E.” të shkolla kanë vërejtë automjetin e zjarrëfikësve që iu ishte marr më herët, i cili qëllimisht ka ardhur në drejtimin e tyre me një shpejtësi shumë të madhe, ndërsa ata edhe pse janë munduar të i shmangen, ka qenë e pamundur, e ka goditur automjetin e tyre duke i gjuajtur në një kanal 2-3 metra të thellë, duke vazhduar sulmin me çrast përsëri është hedhur në veturën e tyre, me çrast ka marrur lëndime në pjesët e ndryshme të trupit.

Dëshmitari H.M. i cili gjithashtu në shqyrtimin gjyqësor ka mbetur pranë deklaratës së dhënë në prokurori, në të cilën kishte pohuar se derisa ishte duke pritur një të afërm të tij ka ardhur një mjet i zjarrëfikësve me rotacion pa zhurmë, me çrast është ndaluar pranë tij, personi i cili ishte duke vozitur ia ka bërë me dorë, ndërsa ai është afruar duke besuar se do ta pyes dicka, por ai i ka dhënë shenjë me dorë që të hy në automjet, me çrast kur ka hyrë e ka parë një fëmijë 5 vjeçar, dhe një armë-psitoletë të cilën ia kishte drejtuar duke i thenë “mos e prek derën”, dhe bashkë me të ka vazhduar në drejtim të fshatit G., me çrast ka arritur të largohen nga automjeti. Me tutje ka shtuar se më herët nuk e ka njohur atë person, dhe se i njëjti ishte nën tension.

Nga raporti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës – Instituti i Psikiatrisë Forenzike numër 406/2 i dt.30.09.2016, mbi gjendjen shëndetit mendor të akuzuarit M.D. të

përpiluar nga ekspertët dr.F. D. neuropsikiatër, dr. G. H. psikiatër, dr. Sh. H. psikiatër, N.H. këshilltar social të cilët në mendimin e tyre përfundimtar kanë konstatuar:

1. Fjala është për një person i cili ka përjetuar mjaft stresse dhe trauma në rrethin ngushtë familjar/vdekjen e gruas së tij në lindje, pastaj vdekja e dy motrave të tij, perjetimet në luftë, ku kishte qenë ushtar dhe kishte qenë i plagosur në kokë. I njëjti ka karaktersistikat e ndryshimit organik të personalitetit, pastaj karakteristikat te personalitetit kufitar, emocionlisht i paqendrueshëm-labil, tolerancë të ulur frustrative, mjaft ankesa adoptive, somatike dhe neurotike,
2. Tempore criminis, motivi për veprën ka qenë i pakuptueshem psikologjikisht, në saje të karaktersitikave të shënuara me lartë, ai nuk ka pas kapacitet intelektual për të gjykuar drejtë për rëndësinë e veprës si dhe mundësia e kontrollit të veprimeve të tij ka qenë mjaft e zvogëluar.
3. Në këtë menyër llogaritshmëria për veprën ka qenë e zvogëluar esencialisht.
4. Propozojm gjykatës që të njëjtit t'ia shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshme me ndalës në IPEK, mas e cila do të ndikoj pozitivisht në parandalimin e veprimeve të dëmshme dhe korigjimin e sjelleve në të ardhmen. Masa do të jetë e përkohshme dhe në përkujdesje të ekipit multidiciplinar të IPFK i cili me kohë do ta lajmëron gjykatën për ecurinë e kësaj mase dhe gjendjen e tij në vazhdim.
5. I njëjti është i aftë të marrë pjesë në procesin gjyqësor mirëpo deponimet e tij janë mjaftë të dëmtuara.

Nga foto-albumi i datë 14.07.2016 i cili i është bashkangjitur shkresave të lëndës gjykata ka vërtetuar vendin ku është kryer vepra penale.

Në këto kushte, nga përmbajtja e akteve psikiatriko-ligjore të marra në cilësinë e provës, pas shqyrtimit të përmbajtjes dhe konkluzioneve të tyre, si dhe deshmive te deshmitareve, pohimeve te eksperteve, gjykata ka arrit në konkluzionin përfundimtarë që ndaj të pandehurit M. D., janë permbushur kushtet ligjore për shqiptimin e Masës së Trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësorë në pajtim me nenin 89 par. 1 pika 1.1,1.2,1.3,1.4 dhe 1.5 të KPRK, pasi që është konstatuar se i pandehur ka kryer veprën penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 365 par 4 lidhur me par. 1 të KPRK, për të cilën është paraparë denim prej një deri në dhjetë vjet burgim dhe veprën penale Grabitje nga neni 329 KPRK, për të cilën është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre deri në dymbëdhjetë vjet. Po ashtu bazuar në konstatimet e dalura nga ekspertiza dhe elaborimin gojor të së njëjtës nga ekspertet e lartë referuar ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër tjetër penale dhe se trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale. I njëjti është trajtuar edhe më herët mirëpo ky trajtim ka qenë i shkurtër dhe pa rezultat, ndërsa gjykata vlerëson se një trajtim në Institucion do mundësojë përcjelljen e gjendjes shëndetësore të tij në mënyrë permanente, nga ekipi profesional konform gjendjes së tij.

Gjithashtu gjykata vlerëson se nga mënyra e kryerjes së veprave penale të pershkuara si në dispozitivin e këtij aktvendimi, mungesa e aftësisë së të pandehurit për të kontrolluar veprimet e tij dhe gjendja shëndetësore e tani të pandehurit, trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim si masë e nevojshëm për të shmangur rrezikun serioz, që i njëjti paraqet për rrethin ku jeton, por njëherit që i pandehuri të rikthehet sadopak në rrethin familjar dhe shoqëror. Po ashtu sa i përket aftësisë së të pandehurit për t'u përballur me gjykimin, nga ekspertiza e referuar vërtetohet se i njëjti është i aftë për të marr pjesë në procesin gjyqësor, mirëpo deponimet e tij janë mjaft të dëmtuara, po ashtu edhe në shqyrtim gjyqësor Eksperti dr. F.D. pas një konsulte të shkurtër me të

pandehurin M.D. për të konstatuar gjendjen shëndetësore të tij nëse është në gjendje të përcjellë procesin gjyqësor, ka konstatuar se i njëjti është në gjendje që pjesërisht të përcjellë këtë shqyrtim gjyqësor, kur e them pjesërisht nënkuptohet se përgjigjet e tij do të jenë me dëmtime në kuptueshmërinë dhe në gjykimin e tij, gjithnjë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Gjykata kishte parasysh edhe vetë qëndrimin e të pandehurit në shqyrtim, dukjen e tij të çrregulluar, mungesën e vetëdijes mbi vetën për vendin ku është, që manifestohej me mungesë të reagimit gjatë gjithë kohës, mbajtjen e kokës ulur, duke qenë i pandjeshëm ndaj pranisë së personave tjerë afër tij.

Përgjegjësia penale lidhet në mënyrë të ngushtë me aftësinë e personit për të kuptuar natyrën e paligjshme të sjelles së tij, si edhe për të kontrolluar veprimet ose mosveprimet në përputhje me kërkesat e ligjit. Prandaj nga arsyet e paraqitura më lart, dhe nga fakti se përgjegjësia penale lidhet në mënyrë të ngushtë me aftësinë e personit për të kuptuar natyrën e paligjshme të sjelles së tij, si edhe për të kontrolluar veprimet ose mosveprimet në përputhje me kërkesat e ligjit dhe në zbatim të Kodin Penal, konkretisht të neni 18 par 2, në të cilen dispozitë parashikohet shprehimisht përgjegjësia penale e personave të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë në kushtet e aftësisë esencialisht të zvogëluar, rezulton i bazuar propozimi për shqiptim të masës së trajtimit të detyruar psikiatrik, pasi që kjo gjykatë ka vërtetuar se tani i pandehuri i ka kryer veprat penale në gjendje të paaftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të njëjtit i shqipton masën e trajtimit të detyruar psikiatri me ndalim në Institucionin e Kujdesit shëndetësor – Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës Prishtinë.

Masa e trajtimit të detyruar psikiatrik e shqiptuar ndaj tani të pandehurit do të zgjasë derisa Institucioni shëndetësor përgjegjës për shërimin mendor të konstatojë se më nuk është e nevojshme që i pandehuri të mbahet i ndaluar për shërim.

Institucioni shëndetësor ku tani i pandehuri do të mbahet në ndalim për trajtim të detyruar psikiatrik ka për obligim që gjykatën së paku në çdo gjashtë muaj ta njoftoj për gjendjen shëndetësore të tani të pandehurit dhe suksesin e trajtimit.

Kjo gjykatë ka për detyrë që së paku në çdo gjashtë muaj të shqyrtojë nevojën e vazhdimit të masës së trajtimit të detyruar, të shqiptuar sipas këtij aktvendimi.

Vendimin për udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore juridike t'a realizojë në kontest të rregullt civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 të KPP.

Për arsye se tani i pandehuri nuk është shpall fajtor shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga shpenzimet publike.

Nga se u tha më lartë, e në bazë të nenit 514 par. 3 të KPPë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PKR.nr. 604/16 me datë 10.11.2016Sekretarja juridike

Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja
Suzana Çerkini

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda tetë (8) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktvendimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.